



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 815/ prot.

Tiranë, më 03.03.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

Z. R. Z

I nderuar z. Z

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion datë 15.2.2022, protokolluar me tonën datë 24.2.2022, ju informojmë si më poshtë:

Për subjektin e rivlerësimit **F H** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur të përfundojë procesin pa vendim përfundimtar. Ky vendim i Komisionit ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Për subjektin **R B** Komisioni pasi ka kryer hetimin administrativ në të tre kriteret e rivlerësimit ka vendosur në datë 26.4.2019, konfirmimin në detyrë të këtij subjekti. Vendimi i Komisionit ka marrë formë të prerë pasi nuk u ankimua.

Për subjektin **A B** Komisioni ka vendosur në datë 18.11.2019, shkarkimin nga detyra. Vendimi i Komisionit është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, aktualisht ky ankim është në proces shqyrtimi nga Kolegji.

Për subjektin **T H** komisioni ka vendosur në datë 17.9.2020, shkarkimin nga detyra. Ndaj këtij vendimi subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Vendim i Komisionit ndaj subjektit H është në proces shqyrtimi nga Kolegji.

Për subjektin e rivlerësimit **D A**, Komisioni ka vendosur në datë 26.5.2021, shkarkimin nga detyra.

Edhe ky vendim është ankimuar në Kolegjin nga vet subjekti i rivlerësimit dhe aktualisht është në proces shqyrtimi nga ky institucion.

Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektet që ju jeni i interesuar i gjeni të publikuara në faqën zyrtare përmes këtij linku në internet <https://kpk.al/vendime/>.

Faleminderit!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

